

DEKLARATE PËLQIMI

Unë i nënshkruari _____ datëlindje _____, i identifikuar me dokument Identifikimi _____, madhor/e, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, *me cilësinë time si Klient i Bankës, **DEKLAROJ** dhe shpreh **PËLQIMIN TIM** për përpunimin e të dhënave të mia personale nga Banka si më poshtë si vijon:*

1. Deklaroj se i gjithë informacioni i dhënë Procreditbank nga unë është i saktë dhe i vërtetë dhe jam dakort që të dhënat e mia personale të deklaruara pranë Procreditbank në momentin e regjistrimit dhe përgjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies me bankën, të përpunohen vetëm në kuadër të FATCA dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional.
2. Autorizoj Procreditbank që për arsye të zbatimit të detyrimeve të FATCA dhe vlerësimit të statusit tim, të verifikojë saktësinë dhe plotësimin e informacionit të dhënë nga ana ime, të shkëmbejë këtë informacion me Autoritetin amerikan “Internal Revenue Service”- “IRS”, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional.
3. Autorizoj në mënyrë të parevokueshme Procreditbank, të përpunojë, transferojë dhe të trajtojë, të gjitha të dhënat e mia personale dhe financiare të deklaruara prej meje, të tashme dhe të ardhme, tek Autoriteti amerikan “Internal Revenue Service”-“IRS”, kompania Mëmë apo cdo palë tjetër që mund të jetë e nevojshme, vetëm për qëllim të realizimit dhe implementimit të FATCA sa herë që kërkohet. Të dhënat subjekt i këtij përpunimi dhe transmetimi janë: Emër Mbiemër, Adresa, Numri i Identifikimit i Taksapaguesit (TIN), Numri i llogarisë/llogarive, balanca e llogarisë/llogarive të tij në një moment të caktuar ose në momentin e mbylljes së llogarisë/llogarive nga klienti, kreditimet ose pagesat që janë kryer nga llogaria/llogaritë, si dhe cdo informacion shtesë të kërkuar nga IRS.
4. Në rastet kur Procreditbank vlerëson që të kontrakttojë palë të treta, kompani të tjera për realizimin e përbushjes së qëllimit të implementimit të FATCA, jap pëlqimin për përpunimin nga këto kompani të të dhënave të deklaruara prej meje pranë Procreditbank, vetëm dhe në funksion të implementimit të FATCA.
5. Procreditbank më garanton se janë marrë të gjitha masat për trajtimin e sigurtë të të dhënave personale dhe financiare të mia si Klient, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar dhe profesional.
6. Kjo Deklaratë Pëlqimi do të jetë në fuqi deri në përfundim të marrëdhënies kontraktuale me Procredit Bank dhe detyrimeve që burojnë në kuadër të FATCA.

E lëshoj këtë Deklaratë Pëlqimi me vullnet të lirë, dhe me qëllim përpunimin e të dhënave personale nga Procreditbank sh.a, që lidhen dhe burojnë specifikisht dhe vetëm për qëllimin e realizimit të implementimit të FATCA, në përputhje me legjislacionin përkatës.



Përmbajtja e kësaj Deklarate Pëlqimi është përpiluar në zbatim dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji si dhe Udhëzimin e BSH Nr.31, datë 08.05.2002 "Për Sekretin Bankar".

Emër **Mbiemër**

Data: _____

Vendi: _____